



Tubimi me komunitetin në lagjen “Ulpiana” – Soliterat e Ulpianës

Data: 15.07.2022

Lokacioni: Shkolla fillore “Hasan Prishtina”

Pjesmarrës:

Komuna e Prishtines:

Idriz Maliqi

Arbër Sadiki

Banorët e lagjes:

1. Joze simoni	Ekonomist
2. Njomza Kastrati	Pianiste
3. Valon Murati	Ekonomist
4. Bedri Azemi	Punëtor
5. Daut Krasniqi	Axhustator
6. Feti Halimi	Punëtor
7. Shani Pozhegu	Pensionist
8. Lidija Tupeci	Pensioniste
9. Anita Shehu	Infermiere
10. Ardiana Pajaziti	Gazetare
11. Fimim Vokrri	Ekonomist
12. Sefer Avdijaj	Dr. i Fizikes
13. Lulezim Qitaku	Vozitës
14. Rasim Statovci	Pensionist
15. Burim Bunjaku	-----
16. Lindita Rexhepi	Ekonomiste
17. Bashkim Binaku	Ekonomist
18. Flamur Binaku	-----
19. Faik Beshiri	Pensionist
20. Muharrem Beshiri	Biolog
21. Naim Qorroli	Ushtarak
22. Gani Havolli	Teknik i elektrikës

Mediat:

Klan Kosova



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të takimit me qytetarë të lagjes “Ulpiana”- Soliterat e Ulpianës, në Prishtinë

Arbër Sadiki nga Drejtoria e Urbanizmit, shpjegoi qëllimet dhe objektivat e këtij projekti, duke analizuar propozimin e kryetarit gjatë fushatës zgjedhore, pra si një mundësi që të krijohet një qendër e kësaj lagjeje, që do t'u shërbente banorëve për qëllime të ndryshme, të cilat qëllime do të propozohen nga komuniteti. P.sh. në katin e parë është propozuar për kafeteri, ndërmarrje tregtare me pakicë, gjithashtu parkingun nëntokësor për makina, ku do të krijoheshin hapësira për gjelbërim dhe kënde lodrash për fëmijë etj.

Me planifikimin e Unazës së Qytetit, është paraparë që një numër i konsiderueshëm i veturave të akomodohen ne parqe nëntokësore etj.

Gjate diskutimit me banorët e lagjes, ata dhanë disa propozime në lidhje me projektin e prezentuar nga Komuna e Prishtinës, siç në vazhdim:

- Sa është lartësia e objektit që do t'i lidhë kota solitera?
- Kush i shfrytëzon këto hapësira?
- A ka të drejtë të ndryshohet destinacioni i hapësirave pas një kohe?
- Pronësia – kush do të jetë pronar i këtyre hapësirave me lokale për biznes – përqindja që i takon?
- Gazrat e veturave mbesin ende në një shkallë të lartë në këtë lagje?
- A do kemi reduktim te ujit dhe a do të kemi probleme me kanalizimin?
- Analiza e kost-benefit, sa do përfitojnë banorët dhe cilat janë objektivat?

Ne do t'i analizojmë këto kërkesa dhe planifikojmë të kemi së shpejti takimin e radhës.